

L I G J
Nr.8489, datë 19.5.1999

**PËR TËRHEQJEN E REZERVËS SË NENIT IX TË KONVENTËS “PËR
PARANDALIMIN DHE DËNIMIN E KRIMIT TË GJENOCIDIT”, ADOPTUAR NGA
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E OKB-SË MË 9 DHJETOR 1948, BËRË NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MË 12 MAJ 1955**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Tërhiqet rezerva e nenit IX të Konventës “Për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit”, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 9 dhjetor 1948, bërë nga Republika e Shqipërisë më 12 maj 1955.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2388, datë 7.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**